



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 10

Prishtinë, më 22 mars 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Kolë Berisha dhe Selvije Halimi

Munguan: Adem Salihaj, Mufera Şinik dhe Radmila Vujović (në udhëtim zyrtar).

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lavdim Krasniqi – IGJK, Donika Voca – KNN, Gjita Lushi – Kosova Sot, Fatbardha Zekaj – Bota Sot, Lumnije Murati – ZKRK, Sheribane Vova – KDI, Albulena Ademi dhe Dafina Bardhi – praktikante.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 16 marsit 2010,
3. Përgatitjet për tryezën e rrumbullakët për Projektkodin e drejtësisë për të mitur,
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që për pika të rendit të ditës të radhiten:

Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr 03-P-198, lidhur me kërkesën e Këshillit kundër procesit gjyqësor ndaj Albin Kurtit,

Shqyrtimin i raportit të Agjencisë Kundër Korrupsionit,
Shqyrtimi i shkresës së Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 131/2010,
Shqyrtimi i propozimeve të Institutit Gjyqësor të Kosovës,
Shqyrtimi i kërkesës së IO-së për interpretimin e kontratës së punës.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 16 marsit 2010

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 16 mars 2010 pa vërejtje.

3. Përgatitjet për tryezën e rrumbullakët për Projektkodin e Drejtësisë për të Mitur

Kryetari i njoftoi se të mërkurën, më 24. 03. 2010, në orën 11:15, do të mbahet tryezë për shqyrtimin e Projektkodit të Drejtësisë për të Mitur, në të cilën do të jenë të pranishëm edhe ekspertët e ftuar nga Komisioni.

4. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës nr 03-P-198, lidhur me kërkesën e Këshillit kundër procesit gjyqësor ndaj Albin Kurtit

Kryetari - I njoftoi për përfundimin e Kryesisë së Kuvendit, me të cilin ngarkohet Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione dhe Komisioni për Legjislacionin dhe Gjyqësi ta shqyrtojnë Peticionin e Këshillit kundër procesit gjyqësor ndaj Albin Kurtit. Lidhur me këtë pik hapi debat.

Ibrahim Makolli - Për përfundimin e Kryesisë së Kuvendit tha se Kryesia e Kuvendit si duket nuk është e gatshme të marrë qëndrime për çështjet të cilat janë të ndjeshme, prandaj nuk duhet që rastet e tilla t'i procedojë në komisione, sepse ky peticion i plotëson kushtet të debatohet në Kuvend. Ishte i mendimit që Komisioni t'ia rekomandojë Kryesisë lejen për debat sepse Peticioni i plotëson kushtet të debatohet në Kuvend. I mbetet Kryesisë së Kuvendit të caktojë seancë për këtë çështje.

Armend Zemaj - Duke iu referuar përfundimit të Kryesisë dhe kërkesës së Këshillit kundër procesit gjyqësor ndaj Albin Kurtit tha se kjo shkresë i përmban tri kërkesa: mbylljen e procesit gjyqësor ndaj Albin Kurtit, fillimin e hetimeve për vrasjet e 10 shkurtit 2007 dhe krijimin e një komisioni parlamentar *ad hoc* për t'i hetuar ngjarjet e 10 shkurtit. Në vazhdim tha se kjo duhet të shikohet me vëmendje, sepse nëse kërkesa është dërguar për debat, në rekomandim duhet të përcaktohet saktë se çka do t'i rekomandohet Kuvendit: rekomandimi për debat ose edhe dy kërkesat e tjera të cekura më lart.

Selvije Halimi - Theksoi se shkresa dërguar Kryesisë së Kuvendit kërkon lejimin e debatit duke i përfshirë edhe kërkesat për ngjarjet e 10 shkurtit. Nga ky debat mund të dalin dy përfundime. I pari: Kuvendi t'i drejtohet gjyqësorit për mbylljen e procesit dhe i dyti Kuvendi ta marrë nismën ta formojë një komision *ad hoc* për t'i hetuar ngjarjet e 10 shkurtit 2007. Kuvendi këtë hap nuk mund

ta marrë, sepse kjo është përzjerje në kompetencën e gjyqësorit. Ishte për lejimin e debatit në Kuvend.

Adem Hajdaraj - Tha se nuk mund të paragjykojmë se çfarë rekomandimi mund të nxjerrë Kuvendi i Kosovës. Mund të themi se kërkesa për lejimin e debatit është e ligjshme, sepse është arritur numri i mjaftueshëm i nënshkrimeve, por në asnjë mënyrë t'i paraprijmë Kuvendit.

Bajram Kosumi - Theksoi se Kryesia është dashur të marrë vendim për lejimin e debatit. Pas debatit eventualisht të kërkojë nga Komisioni ta procedojë tutje Peticionin. Kryesia ka kërkuar nga Komisioni ta shqyrtojë, mirëpo në këtë fazë konsideron se nuk duhet të japim mendimin tonë. Në vazhdim tha se Peticioni i ka tri kërkesa: mbyllja e procesit gjyqësor ndaj Albin Kurtit, fillimi i hetimeve për vrasjet e 10 shkurtit 2007 dhe krijimi i një komisioni parlamentar *ad hoc* për t'i hetuar ngjarjet e 10 shkurtit. Ne nuk mund të supozojmë se cili do të jetë qëndrimi i Kuvendit. Si do që të jetë, deklarata që do ta miratojë, Kuvendi i Kosovës nuk mund të ndërhyjë sepse të konsiderohet ndërhyrje në sistemin gjyqësor.

Ibrahim Makolli - Shtoi se nuk mund të qëndrojmë indiferentë ndaj gjithë kësaj situate. Theksoi se në drejtësi nuk ndikojnë peticionet, por ndikojnë faktet. Duke folur për ngjarjet e 10 shkurtit 2007, bëri krahasime dhe tha se sistemi gjyqësor e ka ngritur një proces kundër atyre të cilët kanë qenë viktima. Ky gjyqësor nuk ka ngritur asnjë proces kundër vrasjes së ushtarit të KFORIT-it në vitin 2008 në veri të Kosovës dhe kundër rebelimit të të tjerëve në atë pjesë. Pra Kuvendi nuk mund të ndërhyjë në sistemin gjyqësor, por e ka për detyrë të thotë që drejtësia të veprojë njësoj në tërë territorin e vendit.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

REKOMANDIM

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka konstatuar se peticioni ka bazë ligjore dhe i rekomandon Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës ta procedojë për diskutim në një nga seancat plenare.

5. Shqyrtimin i Raportit të Agjencisë Kundër korrupsionit

Kryetari - Propozoi që shqyrtimi i Raportit të Agjencisë Kundër Korrupsionit të shtyhet për mbledhjen e radhës së Komisionit.

Meqë nuk pati vërejtje kjo pikë mbetet të shqyrtohet në mbledhjen e radhës.

6. Shqyrtimi i shkresës së Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 131/2010

Kryetari - I njoftoi me shkresën e Gjykatës Supreme të Kosovës, lidhur me zbatimin e Ligjit për procedurën kontestimore, përkatësisht të nenit 247.1.a, i cili do të duhej të ishte për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, **përveç nëse (e jo në qoftë se)** shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale. Ky lëshim po shkakton vështirësi dhe pasoja në zbatimin e tij.

Në vazhdim tha se lidhur me këtë çështje marr për detyrë ta sqaroj edhe një herë me gjyqtarë dhe nëse eventualisht vërehen lëshime të tjera, të natyrës së tillë, t'i shqyrtojmë në të njëjtën kohë.

7. Shqyrtimi i propozimeve të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Kryetari - I njoftoi për propozimet e Institutit Gjyqësor dhe shprehu shqetësim për mandatin e kryetarit dhe të Kryesisë së Shoqatës së Juristëve. E ftoi Lavdim Krasniqin ta merrte fjalën.

Lavdim Krasniqi - drejtor i Institutit Gjyqësor të Kosovës – I paraqiti propozimet, që nuk janë propozime të Institutit Gjyqësor, por të institucioneve përkatëse. Nga Gjykata Supreme të Kosovës, Fejzullah Hasani dhe Miodrag Pavić, nga Prokuroria e Shtetit, Vesel Jashari, nga Oda e Avokateve të Kosovës, Destan Rukiqi, nga Fakulteti Juridik, Osman Ismaili, nga Shoqata e Gjyqtareve, Elmaze Syka, nga Shoqata e Prokurorëve të Kosovës, Radica Milic dhe nga Shoqata e Juristeve të Kosovës, Rexhep Murati dhe Ekrem Shabani.

Pas një debati, që u zhvillua nga Komisioni, njëzëri u pajtuan që Kuvendit të Kosovës t'i paraqesë rekomandim që të emërohen anëtarë të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës: Fejzullah Hasani dhe Miodrag Pavić, të propozuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, Vesel Jashari nga Prokuroria e Shtetit, Destan Rukiqi nga Oda e Avokatëve të Kosovës, Osman Ismaili nga Fakulteti Juridik, Elmaze Syka nga Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës dhe Radica Milić nga Shoqata e Prokurorëve të Kosovës.

Komisioni nuk i përkrahu propozimet e Shoqatës së Juristeve të Kosovës.

8. Shqyrtimi i kërkesës së IO-s për interpretimin e kontratës së punës

Komisioni lidhur me kërkesën e IO-s vendosi që me shkresë të njoftohet parashtruesi që neni 12.2 pika (f) të qartësohet, sepse pika (f) e këtij neni nuk figuron as në ligj, as në kërkesë.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni